

VENDIM
Nr.1456, datë 11.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të përfundojë, brenda datës 10 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit për rikonstruksionin e vilave qeveritare dhe blerje makinerie, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2008, sipas anekseve nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Procedurat e prokurimit, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për rikonstruksionin e vilave qeveritare nr.1 në Vlorë, në Velipojë, për studim-projektimin e vilës qeveritare në Dhërmi, si dhe për rikonstruksionin e pjesshëm të vilave qeveritare, në Durrës, e për spostim kaldaje në vilën Pogradec, për vitin 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përfundojë brenda datës 10.12.2008.

3. Procedurat e prokurimit, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për blerje makinerie “Zetor”, për pastrimin e rërës në zonën e vilave qeveritare, Durrës, për vitin 2008, sipas aneksit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përfundojë brenda datës 25.11.2008.

4. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

LISTA E AUTORITETIT KONTRAKTOR: DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

1. Rikonstruksion, vila qeveritare nr.1 Vlorë, me fond limit 108.299.166 lekë.
2. Rikonstruksion, vila qeveritare Velipojë, me fond limit 42.800.000 lekë, rishpallur dy herë.
3. Rikonstruksion i pjesshëm i vilave qeveritare Durrës, me fond limit 14.873.000 lekë.
4. Spostim kaldaje dhe shtrim pllake, vilat Pogradec, me fond limit 4.190.000 lekë.
5. Studim-projektim, rikonstruksion vila Dhërmi, me fond limit 1.416.666 lekë, rishpallur dy herë.

ANEKSI NR.2

LISTA E AUTORITETIT KONTRAKTOR: DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE

1. Blerje makinerie për pastrimin e rërës, vilat qeveritare Durrës, me fond limit 545 833 lekë, rishpallur dy herë.